



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni vjeshtor

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 75

Prishtinë, më 7 shtator 2010, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylaj, Teuta Hadri, Flora Brovina, Vezira Emrush dhe Qamile Morina.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Zyrës së Komisioneve të Kuvendit, Enis Halimi – zyrtar i fushës, Bardhyl Hasanpapaj - NDI, Nora Sahatçiu - UNDP, Besart Mustafa - praktikant.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 20. 07. 2010
3. Shqyrtimi i Projektligjit të punës
4. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale
5. Rishqyrtimi i planit të punës së Komisionit
6. Të ndryshme.

***Kryesuesi** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari Sadik Idriz propozoi që pika 5 e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjet e radhës.

Komisioni e miratoi rendin e ditës me ndryshime, sipas propozimit të kryetarit të Komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 20. 07. 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

3. Shqyrtimi i Projektligjit të punës

Sadik Idriz - E kemi marrë një draft të hartuar nga grupi i punës dhe na stafi mbështetës i Komisionit. Jam i mendimit se grupi i punës duhet ta shtojë aktivitetin e tij. Tash jemi në përgatitje të vizitës sonë në Slloveni, në fund të shtatorit dhe duhet të bëhen të gjitha përgatitjet lidhur me këtë vizitë.

Rita Hajzeraj - E kemi pasur një takim me kryetarin e Kuvendit, në të cilin është diskutuar për emergjencën e miratimit të ligjeve, për shkak të Raportit të Progresit. Të gjithë kryetarët e komisioneve pa dallim janë pajtuar që projektligjet, që janë në procedurë, të kalojnë në Kuvend deri në fund të shtatorit. E njoftova kryetarin që jemi duke punuar në Komision rreth këtij Projektligji dhe se do ta bëjmë edhe një dëgjim publik që ta finalizojmë Projektligjin e punës. Thashë se duhet të kenë pak konsideratë për shkak të relevancës dhe ndërlikueshmërisë së tij, sidomos rreth disa neneve, si p.sh. neni për pushimin e lehonisë etj. Vizita në Slloveni do të ishte mirë të bëhej më herët, që pasi të kthehemi nga Sllovenia ta finalizojmë Projektligjin.

Teuta Hadri - Nuk ka nevojë ta bëjmë edhe një dëgjim tjetër publik. Të gjithë jemi të bindur se Projektligji do të kalojë. Ne, si Komision, duhet të bëjmë presion të Qeveria, sidomos për nenin 48. Përndryshe, ky Projektligj nuk do të mund të futet në agjendë për miratim deri në fund të shtatorit.

Sadik Idriz - Nuk jam për dëgjim publik, por vetëm për atë që grupi punues t'u bëjë ftesë Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Ministrisë së Financave dhe t'i marrim nga këto ministri qëndrimet e tyre, që kur të vendosim të mos dalim joserioz. Jemi zotuar se në nuk do ta votojmë Projektligjin në këtë formë, pra me tre muaj pushim të lehonisë. Ne e kryejmë detyrën tonë dhe është çështje tjetër nëse kthehet nga Ministria e Financave ose nga Komisioni për Buxhet.

Gjylnaze Sylja - Detyrë e Komisionit është ta bëjë Projektligjin sa më të mirë, ndërsa çështja e financave duhet të jetë temë për ministrinë përkatëse. Ne jemi Komision udhëheqës, që duhet t'i bindim të tjerët se kjo është zgjidhja më e mirë për Projektligjin. Ndërkaq, sa i përket vizitës në Slloveni, nëse shkojmë pasi të kryhet Projektligji, nuk ka kuptim të bëhet vizita. Është mirë që ky Projektligj të kryhet brenda afatit, por meqë është projektligj bazik, më mirë është të marrim pak më shumë kohë sesa ta kalojmë vetëm për hir të afateve kohore.

Sadik Idriz - Sa i takon vizitës në Slloveni, atje nuk do të shkojmë vetëm për këtë çështje. Këtë vizitë do ta shfrytëzojmë edhe për marrjen e përvojave, që kanë të bëjnë edhe me çështje të tjera, të cilat na presin në të ardhmen.

Nurishahe Hulaj - Duke e ditur rëndësinë e këtij Projektligji e kemi zhvilluar aktivitet të madh. Kemi mbajtur një dëgjim publik dhe i kemi mbajtur 12 takime lidhur me këtë Projektligj, me qëllim që të përfshihen të gjithë sektorëve. I kemi evidencuar të gjitha amendamentet e propozuara nga palët e interesuara. Tash është mirë ta përcaktojmë dinamikën e aktiviteve, që ta përgatisim këtë Projektligj brenda afatit kohor. Duhet të sigurohemi se do ta kemi mbështetjen e ministrive përkatëse, sidomos për nenin 48, i cili është pikë e ndjeshme. Grupi i punës duhet të mbledhet dhe të punojë shumë, në mënyrë që ky Projektligj të kryhet, më së largu, deri në ditët e para të tetorit.

Teuta Hadri - Është mirë që Komisioni të dalë më dy propozime për nenin 48. Të dy propozimet, secili në mënyrën e vet, ta parashohë që pushimi i lehonisë të jetë 1 vit. Kjo do të krijonte mundësi që njëri nga propozimet të kalojë dhe me këtë të arrihet qëllimi për pushimin 1 vjeçar të lehonisë.

Rita Hajzeraj - Jam për dëgjim publik, sepse e di rëndësinë e Projektligjit. Ne edhe për projektligje të tjera kemi mbajtur nga disa dëgjime publike. Dëgjimi publik duhet të mbahet që të jemi sa më transparentë, sepse për këtë projektligj ka shumë propozime. Me dëgjim publik do ta dëshmohej një lloj vlerësimi për palët e interesuara, të cilat kanë dhënë kontributin e tyre të çmuar.

Qamile Morina - Me shkuarjen në Slloveni do të mund ta jepnim kontributin tonë për çështjet, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, të cilat nuk do të kishin implikime buxhetore. Ne duhet të punojmë shumë dhe të bëjmë tryzni maksimale që Projektligji i punës të miratohet dhe nuk duhet të lejojmë që ai të kthehet.

Vezira Emrush - Nuk kam mundur t'i kem dy amendamente të Projektligjit, që janë shumë të rëndësishme. Besoj se e keni lexuar pjesën, në të cilën flitet për parashkrimin e ligjit. Aty thuhet se parashkrimi ndodh pas 3 vjetësh. Kam hulumtuar, duke qenë edhe vetë vizitë në Maqedoni dhe në Mal të Zi. Edhe sipas së drejtës ndërkombëtare Ligji për punën nuk parashkruhet. Po ashtu duhet një amendament tjetër, me të cilin duhet ta rregullojmë kontratën e punës. Duhet t'i dallojmë kontratën e punës dhe kontratën mbi vepër. Gjithashtu duhet t'i definojmë çka do të thotë punë me kohë të caktuar dhe kohë të pacaktuar dhe detyrimet e punëdhënësit ndaj punëtorit në punën me kohë të caktuar dhe në punën në kohë të pacaktuar. Mendoj se këto gjëra, në këtë Projektligj, qëllimisht janë anashkaluar. Shembull i freskët është ajo çka po ngjet me Postën. E kemi një propozim të Qeverisë për privatizim, pa një program social. Pra, Posta është llogaritur si mjet themelor, ndërsa punëtorët fare nuk janë marrë në konsideratë. Ne, si Komision, duhet të bëjmë diçka në këtë drejtim.

Bardhyl Hasanpapaj - Së bashku me UNDP-në kemi shprehur gatishmëri t'ju ndihmojmë teknikisht dhe financiarisht për vizitën në Slloveni. Jemi të gatshëm t'i sqarojmë të gjitha hollësitë për këtë çështje. Lidhur me Projektligjin e punës kemi punuar shumë. Puna përfundimtare lidhur me amendamentimin duhet të bëhet në

Komision. Do të shikojmë mundësinë që për grupin e punës ta organizojmë në një ambient të përshtatshëm një takim njëditor që ai të marrë qëndrim definitiv lidhur me çështjet e ngritura. Ne kemi bërë një analizë 40-faqëshe që do të jetë një ndihmesë për Komisionin, sidomos për çështjet, që lidhen me Bashkimin Evropian.

Flora Brovina - Jemi në fazën kur grupi i punës duhet të punojë shumë, sepse kemi shumë amendamente, që duhet të procedohen, në mënyrën që vendoset në Komision. Pra, në këtë fazë duhet t'i sistematizojmë mendimet tona lidhur me Projektligjin.

Nora Sahatçiu - Ju përkrahim për udhëtimin në Slloveni. Duhet që të përshtatet mirë agjenda dhe të organizohet sa më mirë kjo vizitë. Një grup i punës nga Ministria e Shëndetësisë për strategjinë sektoriale do ta bëjë një vizitë në Slloveni. Do të ishte mirë që ta kemi një vizitë të përbashkët në Slloveni.

Sadik Idriz - Grupi i punës duhet të punojë me intensitet. Dëgjim publik nuk do të mbajmë, sepse tash është koha e konkretizimit dhe e vendosjes për këtë Projektligj. Deri në fund të shtatorit duhet ta organizojmë vizitën në Slloveni dhe nuk duhet ta shtyjmë më, sepse dalim joserioz. Kjo është vizita e parë e Komisionit jashtë Kosovës, përveç asaj në Bullgari, në të tri legjislaturat e Kuvendit. Prandaj, është mirë ta organizojmë sa më mirë këtë vizitë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale

Sadik Idriz - Komisioni për Legjislacion ka pasur vërejtje në amendamentet tona, si në: amendamentet 24, 27 dhe 63. Komisioni për Legjislacion konsideron se amendamentet 24 dhe 27 janë në kundërshtim me Ligjin për shërbimin civil. Sa i përket amendamentit 63 Komisioni ka konstatuar se ajo çështje rregullohet me ligj tjetër dhe se ky amendament nuk është i nevojshëm. Propozoj që grupi i punës për këtë Projektligj të diskutojë për këto gjëra, sepse e dimë se kemi pasur vërejtje kur kemi diskutuar lidhur me çështjen e zgjedhjes së shefit ekzekutiv të Agjencisë për Produkte dhe Pajisje Medicinale. Propozoj që grupi i punës ta thërrasë në mbledhje kryetarin e Komisionit për legjislacion, z. Bahri Hyseni, dhe ekspertin që ka punuar në këtë Projektligj dhe aty t'i harmonizojnë qëndrimet që neve në Komision të na i paraqesin qëndrimet e harmonizuara. Po ashtu duhet të jetë i pranishëm në mbledhje edhe kryetari i Komisionit për Buxhet.

Gjylnaze Sylja - Përpjekjet e grupit të punës ishin që të mos lejojë që, një industri e cila është më profitabilja në botë, siç është ajo farmaceutike, të krijojë një ambient ku do të ketë keqpërdorime. Meqenëse qendra e atyre keqpërdorimeve është njeriu, i cili e ka pushtetin, atëherë jemi munduar ta bëjmë një lloj balance dhe kontroll të Kuvendit mbi Qeverinë. Propozoj që fillimisht të takohemi me ekspertin e pastaj t'i ftojme kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe kryetarin e Komisionit për Legjislacion.

Rita Hajzeraj - Propozoj që të hënën t'i thërrasim kryetarët e dy komisioneve të përmendura, por përpara të mblidhemi ne, anëtarët e grupit të punës, me ekspertin.

Komisioni vendosi që grupi i punës i Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale të mbajë mbledhje me ekspertin dhe t'i ftojë kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe kryetarin e Komisionit për Buxhet, që t'i harmonizojnë qëndrimet lidhur me këtë Projektligj.

5. Të ndryshme

Sadik Idriz - E kemi një ftesë nga Sindikata UNIA nga Zvicra për vizitë tonë në Zvicër. Ata i kanë ftuar njerëzit e caktuar nga Komisioni ynë dhe deputetin Emrush Xhemajli. Duhet të diskutojmë si duhet ta procedojmë këtë ftesë tash, si do t'i përgjigjemi, a do të kemi mundësi të udhëtojmë dhe si do ta organizojmë këtë udhëtim. Në ftesë janë të specifikuara cilat shpenzime i mbulojnë ata e cilat Kuvendi.

Gjylnaze Sylja - Kam një obligim që e kam marrë më herët dhe për këtë arsye unë heq dorë nga ky udhëtim, megjithëse jam e ftuar.

Flora Brovina - Kujtoj se është vizitë e rëndësishme, sepse kemi të bëjmë me një çështje shumë humane, atë të ndalimit të pensionit vetëm për punëtorët e vendit tonë.

Nurishahe Hula – Është vizitë e rëndësishme, për një çështje shumë të rëndësishme dhe për organizim të saj duhet të na mbështesë edhe Kuvendi.

Teuta Hadri - Propozoj që në vizitë të përfshihet edhe dikush nga Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës.

Sadik Idriz - Në Zvicër do ta shohim si funksionon sistemi i sigurimit të të moshuarve, pensionet e trashëguara etj. Po ashtu, çështje për diskutim do të jetë edhe problemi për pensionet e njerëzve tonë atje. Sindikata UNIA mendon se ne mund të ndikojmë shumë më tepër se Ministria për zgjidhjen e këtij problemi. Problemi më i madh është se nuk kemi ligj, që e rregullon këtë çështje, pra çështjen e sigurisë se në Kosovë nuk do të ketë manipulime. Neve na kanë thënë se në dy raste, kanë pasur kërcënime me vdekje, nëse lajmërojnë se dikush nga anëtarët e familjes ka vdekur. Si Komision kemi premtuar se do të kontribuojmë që kjo çështje të tejkalohet. Autoritetet zvicerane që nga Pavarësia e Kosovës kanë kërkuar të fillojë dialogu me Ministrinë tonë lidhur me këtë çështje, por Ministria jonë nuk e ka bërë këtë. Këtu më së shumti e pësojnë njerëzit tanë. Pas vizitës atje, do ta hartojmë një raport të cilin do ta paraqesim para Komisionit.

Komisioni vendosi që të premtën, më 10 shtator 2010, të udhëtojë për vizitë në Zvicër. Në vend të deputetes Gjylnaze Sylja, për vizitë në Zvicër do të udhëtojë deputetja Qamile Morina.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10

E përqatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz